

RAPORTI PARAPRAK
I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
PËR
PLANIN LOKAL TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË
MBETJEVE 2025-2030




Tabela e Përmbajtjes

1. Përmbledhje joteknike	4
1.1 Hyrje, pasqyrë e përmbajtjes dhe objektivat e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, bashkia Patos 2025-2030	4
1.2 Popullsia dhe sasia e mbetjeve	5
1.3 Sistemi ekzistues i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve	6
1.4 Objektivat e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.	7
1.5 Gjëndja aktuale mjedisore dhe problematikat kryesore.	8
2. Hyrje	10
2.1 Qëllimi i studimit VSM	11
2.2 PLMIM dhe konteksti i përgatitjes së tij	12
2.2.1 Pasqyra dhe objektivat e PLMIM	13
2.2.2 Politikat dhe Standartet kombëtare	16
2.2.3 Kuadri institucional	16
3. Përshkrimi i aspekteve mjedisore kryesore që duhen trajtuar në studimin e VSM	16
3.1 Shtrirja gjeografike	16
3.2 Shtrirja kohore	17
3.3 Aspektet mjedisore kryesore që duhet të trajtohen në studimin e VSM	17
3.4 Objektivat mjedisore në bashkinë Patos	18
3.5 Marrja në konsideratë e objektivave mjedisore në procesin e planifikimit- Bashkia Patos	20
4. Gjendja mjedisore aktuale dhe problematikat kryesore në Bashkinë Patos, përfshirë zhvillimin e mundshëm të mjedisit në mungesë të PLMIM	21
4.1 Përshkrimi i zonës gjeografike dhe parashikimi i popullsisë dhe sasisë së mbetjeve	21
4.1.1 Shtrirja gjeografike	22
4.1.2 Parashikimi për prodhimin dhe grumbullimin e mbetjeve	23
4.1.3 Përbërja e mbetjeve	25
4.1.4 Mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet mbetjet inerte	24
4.2 Përshkrimi i shërbimit ekzistues të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Patos.	25
4.3 Popullsia dhe shëndeti i njerëzve	26
4.3.1 Gjëndja mjedisore dhe problematikat kryesore	
4.4 Biodiversiteti, flora dhe fauna	28
4.4.1 Gjëndja mjedisore dhe problematikat kryesore	
4.5 Përdorimi i dheut dhe tokës dhe asetet materiale	29
4.5.1 Gjëndja mjedisore dhe problematikat kryesore.	
4.6 Uji	30
4.6.1 Gjëndja mjedisore dhe problematikat kryesore	
4.7 Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	31
4.7.1 Gjëndja mjedisore dhe problematikat kryesore	
4.8 Peizazhi	32
4.8.1 Gjëndja mjedisore dhe problematikat	
4.9 Trashëgimia Kulturore	33
4.9.1 Gjëndja mjedisore dhe problematikat kryesore	
5. Vlerësimi i ndikimeve mjedisore	34
5.1 Vlerësimi i alternativave	35

5.2 Qasja metodike për Vlerësimin Strategjik Mjedisor	36
5.3 Profilet e VSM të masave të propozuara	36
5.3.1 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative	37
5.3.2 Trajtimi mekanik	37
5.3.2.1 Përshkrimi i teknologjisë	
5.3.2.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative	
6. Plani i monitorimit	38

1. Përmbledhje joteknike

VSM- ja e përgatitur synon:

-Të integrojë faktorët mjedisorë në përgatitjen e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

-Të përmirësojë Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe të rritë mbrojtjen e mjedisit.

-Të rrisë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe

-Të bëjë vendimmarrjen më të hapur dhe më transparente.

Qëllimi i këtij Vlerësimi Strategjik Mjedor është:

-Të paraqesë informacion rreth PLMIM.

-Të identifikojë, përshkruaj dhe të vlerësoj efektet kryesore të mundshme të PLMIM dhe alternativat e tjera të arsyeshme.

-T'u japë mundësi konkrete dhe në kohë autoriteteve të konsultimeve dhe publikut për të paraqitur opinionet e tyre rreth çdo aspekti të vlerësimit mjedor.

Ky Vlerësim Strategjik Mjedor ka për qëllim të vlerësojë ndikimet mjedisorë të Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për Bashkinë Patos, duke siguruar që zhvillimi i politikave dhe veprimeve të parashikuara të jenë në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtës së mjedisit.

1.1 Hyrje, pasqyrë e përmbajtjes dhe objektivat e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, bashkia Patos 2025-2030.

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane për Bashkinë Patos është një dokument strategjik i domosdoshëm që mundëson zbatimin në nivel lokal të politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, duke shërbyer si udhëzues praktik për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve urbane në territorin e bashkisë.

Ky plan ofron një orientim të qartë strategjik për të ardhmen dhe synon të krijojë një qëndrim të përbashkët ndërmjet të gjithë aktorëve lokalë për të përmirësuar performancën në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

PLMIM përqendrohet në veprime konkrete dhe të detajuara që lidhen me:

- Grumbullimin,
- Trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve,
- Trajtimin final dhe menaxhimin e impianteve të dedikuara për mbetjet.

Qëllimi i këtij plani është të përballojë sfidat e reja që ka Bashkia Patos për të siguruar ofrimin e shërbimeve të pastra, efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke harmonizuar interesat e komunitetit dhe institucioneve publike, duke optimizuar koston e shërbimeve në përputhje me buxhetet e kufizuara vendore.

1.2 Popullsia dhe sasia e mbetjeve

Bashkia Patos përbëhet nga 3 njësi administrative, 1 qytet dhe 18 fshatra. Territori i bashkisë së Patosit shtrihet pjesërisht mbi zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz, e cila përbën një burim natyror të rëndësishëm dhe potencial për zhvillimin ekonomik. Sektorët që ofrojnë punësim për banorët e zonës janë industria e nxjerrjes së naftës, sektori i ndërtimit, bujqësia, blegtoria dhe pemëtaria. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 82.5 km² me një densitet prej 510.37 banorë/km² sipas Regjistrit Civil.

Tabela 1. Ndarja territoriale e bashkisë Patos

Qarku Fier (Bashkitë)	Nr. i Bashkive	Bashkia	Njësi Administrative	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Fier Patos Roskovec Lushnje Divjakë Mallakastër	6	Patos	Patos	Qyteti Patos, fshatrat Kuqar, Dukas, Rerës, Margëlliç, Rusinjë, Banaj, Grizë Lënginas
			Zharrëz	Zharrëz, Fshat i Ri, Verbas, Frashër, Sheqishte, Belinë
			Ruzhdie	Ruzhdie, Siqecë, Gjinoqarë Drenie, Kasnicë

Sipas Census-it, bashkia numëron 18,227 banorë ndërkohë që, sipas RGJC-së një popullsi prej 41,956 banorë.

Tabela 2 Të dhënat demografike të Bashkisë Patos

Nj.A	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Sipas Regjistrit Civil	Census
Patos (urban+rural)	1 qytet dhe 7 fshatra, Qyteti i Patosit dhe fshatrat Kuqar, Dukas, Rusinjë, Margëlliç, Rerës, Banaj, Grizë-Lënginas.	12,255	
Ruzhdie (rural)	5 fshatra, Ruzhdie, Gjinoqarë, Drenie, Siqecë, Kasnicë.	1,911	
Zharrëz (rural)	6 fshatra, Zharrëz, Fshat i Ri, Verbas, Frashër, Sheqishte, Belinë	4,061	
Total		41,956	18,227


Meqënëse aktualisht nuk ka një sistem monitorimi sasitë e mbetjeve që prodhohen dhe grumbullohen janë përlllogaritur sipas sasisë së mbetjeve të depozituar në pikën e trajtimit të mbetjeve incinerator Fier. Gjatë vitit 2024 janë grumbulluar dhe transportuar 3848,19 ton mbetje urbane.

1.3 Sistemi ekzistues i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve kryhet nga Agjencia e Shërbimeve Publike (ASHP) në varësi të Bashkisë Patos. Referuar të dhënave të ASHP për sasinë e mbetjeve të dorëzuara në pikën përfundimtare të trajtimit të mbetjeve, gjatë vitit 2024 janë grumbulluar dhe transportuar 3848,19 ton mbetje urbane. Norma e gjenerimit të mbetjeve në zonën urbane është përafërsisht 0.7 kg/banorë/ditë ndërsa për zonën rurale nga 0.4 kg/banorë/ditë në 0,7 kg/banorë/ditë. Në zonën urbane, në një pjesë të Njësisë Administrative Ruzhdië si dhe në rrugët kryesore ku infrastruktura është e përshtashme në Njësinë Administrative Zharrëz, grumbullimi i mbetjeve bëhet në kontenier 1.1 m³. Largimi i mbetjeve drejt incineratorit bëhet nga ASHP me anë të mjeteve teknologjike.

Në Njësinë Administrative Zharrëz kryhet dhe grumbullimi i mbetjeve “derë më derë”, për largimin e të cilave përdoren mjete vetëshkarkuese.

Figura 1



Me shërbimin e largimit të mbetjeve vlerësohet mbulimi i 80 % të territorit të bashkisë Patos. Në të gjithë territorin e bashkisë mbetjet mbledhen të padiferencuara. Grumbullimi i mbetjeve në territorin e bashkisë Patos kryhet me pika grumbullimi ku mbetjet nga familjet, subjektet tregtare dhe

institucionet mblidhen sëbashku në koshat publikë. Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve realizohet vetëm nëpërmjet nismave të vogla. Pjesa më e madhe e aktiviteteve për grumbullimin e materialeve të riciklueshme kryhet nga sektori informal. Sfidë për këtë 6-vjeçar është diferencimi i mbetjeve dhe zbatimi i projekteve me këtë fokus.

Ish-venddepozitimet e mbetjeve janë rehabilituar dhe janë kthyer në zona të gjelbëruara.

Agjencia e Shërbimeve Publike kryen shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (grumbullim dhe transport) gjatë 7 ditëve të javës në qytet dhe në Njësinë administrative Zharrëz ndërsa në Njësinë administrative Ruzhdie është 2 herë në javë.

1.4 Objektivat e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Miratuar Maj 2020) është prezantuar një metodologji mbi bazën e prioriteteve të bashkisë për menaxhimin e mbetjeve, për të përcaktuar se cili do të konsiderohet standardi minimal për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Bashkia Patos gjatë 6 vjeçarit të zbatimit të planit lokal për menaxhimin e mbetjeve kërkon mbi të gjitha të konsolidojë shërbimin në zonat ku aktualisht e ofron këtë shërbim, duke rritur gradualisht cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe ta shtrijë atë në zonat ku aktualisht nuk e ofron shërbimin, kryesisht në zonat rurale:

1. Konsolidimi i shërbimit dhe mbulimi 100% i pjesës urbane të bashkisë gjatë periudhës 2025 – 2030.
2. Ngritja dhe forcimi i sistemit të ndarjes së mbetjeve në burim.
3. Zgjerimi i shërbimit nga 85% në 100% gjatë periudhës 2025– 2030.
4. Rritja e mbulimit të kostos operacionale me 10% çdo vit, gjatë periudhës 2025-2030.
5. Përmirësimi i mbledhjes së tarifës dhe efikasitetit financiar të shërbimit.
6. Reduktimi i ndotjes mjedisore dhe mbrojtja e burimeve natyrore.
7. Zhvillimi i bashkëpunimeve me shkolla, komunitetin dhe bizneset për edukim mjedisor.
8. Përfshirja e inovacionit dhe teknologjisë në menaxhimin e mbetjeve.
9. Të promovojmë një ekonomi qarkore në nivel lokal duke reduktuar mbetjet, rritur riciklimin dhe ripërdorimin e materialeve si dhe duke krijuar mundësi të reja ekonomike përmes valorizimit të mbetjeve dhe përfshirjes së komunitetit dhe bizneseve në praktika të qëndrueshme.

Objekti i këtij plani është:

“Të zhvillohet një sistem i integruar, i qëndrueshëm dhe eficient për menaxhimin e të gjitha rrymave të mbetjeve në Bashkinë Patos, duke përmirësuar infrastrukturën, rritur ndërgjegjësimin qytetar, ulur sasinë e mbetjeve që shkojnë për asgjësim dhe promovuar qasjen e ekonomisë qarkore.”

1.5 Gjëndja aktuale mjedisore dhe problematikat kryesore.

Ndikimet kryesore të mundshme mjedisore nga Plani Lokal I Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve nëse nuk merren masa për zbutjen e tyre duhet të identifikohen dhe të vlerësohen nga VSM. Këto efekte përfshijnë efektet pozitive dhe negative, efektet afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, të përhershëm dhe të përkohshëm si dhe efektet kumulative.

Komponentët mjedisorë dhe objektivat që janë marrë në konsideratë pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3 Objektivat e VSM

Objektivat mjedisor të VSM		
Subjektet e VSM	Objektivat mjedisore	Synime të mundshme të sugjeruara të VSM
Popullata dhe shëndeti i njerëzve	Ruajtja dhe përmirësimi i shëndetit të njerëzve	Përmirësimi i cilësisë së jetës. Mbrojtja e shëndetit të njerëzve.
Biodiversiteti, flora dhe fauna	Mbrojtja e biodiversitetit. Mbrojtja e florës dhe faunës dhe habitatet e tyre natyrore.	Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike. Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe burimeve të tyre natyrore.
Përdorimi i dheut dhe tokës.	Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të tokës. Parandalimi i dëmtimeve të tokës përfshi mbrojtjen e strukturës së tokës (erozioni). Rehabilitimi dhe kthimi në gjendjen e mëparshme të tokës së dëmtuar.	Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të tokës.
Asetet materiale	Përdorimi i kujdesshëm dhe racional i natyrës dhe burimeve të saj.	Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit. Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore.
Uji	Gjëndja e mirë ekologjike e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Gjëndja e mirë kimike e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.	Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i gjendjes së tyre ekologjike. Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i gjendjes së tyre kimike.

Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	Mbrojtja dhe ruajtja e cilësisë së ajrit. Parandalimi dhe reduktimi i ndotjes që shkakton dëmtimin e shtresës së ozonit dhe ndryshimet klimatike.	Reduktimi dhe stabilizimi i emetimit të gazeve serë. Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit.
Trashëgimia kulturore	Ruajtja e trashëgimisë kulturore.	Konservimi dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore.
Peizazhi	Ruajtja dhe restaurimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit	Ruajtja e diversitetit të peizazhit.

Gjëndja aktuale mjedisore

Qyteti i Patosit është një qytet satelit i rajonit dhe qendra e industrisë së naftës. Ai bën pjesë në Rrethin e Fierit ka një sipërfaqe prej 27.8 km² ndodhet 7 km në jugperëndim të qytetit të Fierit, shtrihet përgjatë vargut kodrinor i cili ndan fushën e Myzeqesë nga lugina e lumit Gjanica. Ky varg kodrinor vazhdon në formë harku përgjatë rrugës Patos- Fier. Pika më e lartë e rajonit ndodhet në kodrën e Margëlliçit 320 m mbi nivelin e detit. Përpara qytetit drejt veriut dhe veriperëndimit shtrihet fusha e Myzeqesë ndërsa drejt verilindjes fusha e Roskovecit. Në perëndim kufizohet nga territoret e Njësisë Administrative Portëz, në veri kufizohet me territoret e Njësisë Administrative Zharrës dhe në lindje nga territoret e Njësisë Administrative Ruzhdie. Sipërfaqja sipas relievit ndahet në fushore 730 ha dhe kodrinore 1620 ha.

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve në Bashkinë Patos ofrohet nga sektori publik, nga vetë bashkia. Ky shërbim konsiston në aktivitetet më poshtë:

- Grumbullimi i mbetjeve urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet brenda kontenerëve publik si dhe rreth tyre.
- Dezinfektimi i kontenerëve dhe vendit përreth me gëlqere dhe klor,
- Transportimi i mbetjeve urbane me makinën teknologjike deri në depozitimin e tyre përfundimtar në Incinerator Fier.

Në këtë plan 6 vjeçar, Bashkia Patos parashikon këto shërbime kryesore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat konsistojnë në:

- a. Shërbimi i pastrimit, grumbullimit, transportit të mbetjeve;
- b. Depozitimi i mbetjeve në pikën fundore të depozitimit të mbetjeve Incinerator Fier;
- c. Shërbimi i minimizimit të mbetjeve.

Këto shërbime pasi do të shpjegohen shkurtimisht më poshtë, do të përfshihen në dy skenarët e propozuar nga bashkia për organizimin e shërbimit në territorin e saj gjatë viteve 2025-2030.

Mangësitë mjedisore të sistemit aktual të MIM.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmblëdhur mangësitë mjedisore të sistemit aktual të MIM sa i përket popullatës dhe shëndetit të banorëve.

Tabela 4. Mangësitë mjedisore të sistemit aktual të MIM sa i përket popullatës dhe shëndetit të banorëve

Aktiviteti i MIM	Mangësitë mjedisore
Niveli i ulët i riciklimit dhe mungesa e grumbullimit të diferencuar.	Niveli i ulët i riciklimit con në shfrytëzimin e përgjithshëm të burimeve natyrore. Aktivitetet informale të ndarjes së mbetjeve zhvillohen në kushte pune të këqija
Mungesa e një stacioni magazinimi për mbetjet	Mungesa e stacionit të transferimit e bën të pamundur grumbullimin e mbetjeve në mënyrë të diferencuar.

Zhvillimi i mundshëm i mjedisit në mungesë të PLMIM.

Pritet që të vazhdojë urbanizimi dhe kjo do të rrisë tryshninë që ushtrohet mbi peizazhin dhe mjedisin në zonat urbane. Njëkohësisht pritet që zonat rurale, sidomos ato më të largëta, do të vazhdojnë të kenë largim të popullsisë, gjë e cila do të ketë ndikim pozitiv për habitatet dhe peizazhin.

Nëse PLMIM nuk zbatohet, ndikimet negative në florë dhe faunë mund të mos kontrollohen.

2. HYRJE

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane për Bashkinë Patos është një dokument strategjik i domosdoshëm që mundëson zbatimin në nivel lokal të politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, duke shërbyer si udhëzues praktik për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve urbane në territorin e bashkisë.

Ky plan ofron një orientim të qartë strategjik për të ardhmen dhe synon të krijojë një qëndrim të përbashkët ndërmjet të gjithë aktorëve lokalë për të përmirësuar performancën në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

PLMIM përqendrohet në veprime konkrete dhe të detajuara që lidhen me:

- Grumbullimin,
- Trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve,
- Trajtimin final dhe menaxhimin e impianteve të dedikuara për mbetjet.

Qëllimi i këtij plani është të përballojë sfidat e reja që ka Bashkia Patos për të siguruar ofrimin e shërbimeve të pastra, efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e

saj, duke harmonizuar interesat e komunitetit dhe institucioneve publike, duke optimizuar koston e shërbimeve në përputhje me buxhetet e kufizuara vendore.

Plani parashikon vlerësimin e alternativave më të mira të menaxhimit të mbetjeve, përcaktimin e nevojave për investime kapitale, si dhe vendosjen e një metodologjie të qartë për zbatimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit.

Më konkretisht, PLMIM për Bashkinë Patos synon:

- Sigurimin e përputhshmërisë me Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, duke kontribuar në arritjen e objektivave kombëtare;
- Identifikimin e opsioneve optimale të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane në përputhje me hierarkinë e mbetjeve (parandalim, riciklim, kompostim, trajtim dhe depozitimi përfundimtar);
- Përcaktimin dhe përmirësimin e kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator në nivel lokal, për një menaxhim më efektiv dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Hartimin e një programi të qartë për investime dhe sigurimin e burimeve financiare, si nga buxheti vendor, ashtu edhe nga fondet qeveritare dhe burime të tjera ndërkombëtare;
- Ngritjen e kapaciteteve teknike dhe administrative në Bashkinë Patos për implementimin dhe ndjekjen e Planit.

2.1 Qëllimi i studimit VSM

Si pjesë e përgatitjes së PLMIM, bashkia Patos është duke kryer një Vlerësim Strategjik Mjedisor për të shqyrtuar efektet e tij të mundshme mjedisore. Kjo VSM synon:

- Të integrojë faktorët mjedisorë në përgatitjen e PLMIM.
- Të përmirësojë PLMIM dhe të rrisë mbrojtjen mjedisore.
- Të rrisë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe
- Ta bëjë vendimmarrjen më të hapur dhe më transparente.

Qëllimi i këtij Vlerësimi Strategjik Mjedisor është:

-Të paraqesë informacion rreth PLMIM.

-Të identifikojë, përshkruajë dhe të vlerësojë efektet kryesore të mundshme të PLMIM dhe alternativat e tjera të arsyeshme.

-T'u japë mundësi konkrete dhe në kohë Autoriteteve të konsultimeve dhe publikut për të paraqitur opinionet e tyre rreth cdo aspekti të vlerësimit mjedisor.

Faktet kryesore që lidhen me PLMIM paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 5 PLMIM

Emri i autoritetit përgjegjës	Bashkia Patos
-------------------------------	---------------

Titulli i planit	“Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030”.
Sfondi	Menaxhimi i mbetjeve i është deleguar njësisë të vetëqeverisjes vendore që nga viti 1994, duke i bërë ato përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e këtij shërbimi jetik. Hartimi i PLMIM është një detyrim ligjor i përcaktuar në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar, ku neni 12, pika 2, përcakton se: “Çdo njësi e qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me Planin Kombëtar dhe Planin Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”.
Subjekti	Menaxhimi i mbetjeve të ngurta bashkiake.
Periudha kohore	PLMIM do të shtrihet në afatin koho 2025-2030
Zona e mbulimit	Territori i bashkisë Patos.
Objektivat specifik të PLMIM	Objektivat specifikë të PLMIM janë: -Analiza e situatës së menaxhimit të mbetjeve të ngurta. -Përcaktimi i synimeve dhe objektivave strategjikë. -Zhvillimi i një koncepti financiar dhe masave për ndërgjegjësimin e publikut. -Përgatitja e një plani veprimi.

2.2 PLMIM dhe konteksti i përgatitjes së tij

2.2.1 Pasqyra dhe objektivat e PLMIM

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për Bashkinë Patos është një dokument strategjik i domosdoshëm që mundëson zbatimin në nivel lokal të politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, duke shërbyer si udhëzues praktik për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve urbane në territorin e bashkisë.

Ky plan ofron një orientim të qartë strategjik për të ardhmen dhe synon të krijojë një qëndrim të përbashkët ndërmjet të gjithë aktorëve lokalë për të përmirësuar performancën në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

PLMIM përqendrohet në veprime konkrete dhe të detajuara që lidhen me:

- Grumbullimin,
- Trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve,
- Trajtimin final dhe menaxhimin e impianteve të dedikuara për mbetjet.

Qëllimi i këtij plani është të përballojë sfidat e reja që ka Bashkia Patos për të siguruar ofrimin e shërbimeve të pastra, efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke harmonizuar interesat e komunitetit dhe institucioneve publike, duke optimizuar koston e shërbimeve në përputhje me buxhetet e kufizuara vendore.

Plani parashikon vlerësimin e alternativave më të mira të menaxhimit të mbetjeve, përcaktimin e nevojave për investime kapitale, si dhe vendosjen e një metodologjie të qartë për zbatimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit.

Më konkretisht, PLMIM për Bashkinë Patos synon:

- Sigurimin e përputhshmërisë me Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, duke kontribuar në arritjen e objektivave kombëtare;
- Identifikimin e opsioneve optimale të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane në përputhje me hierarkinë e mbetjeve (parandalim, riciklim, kompostim, trajtim dhe depozitimi përfundimtar);
- Përcaktimin dhe përmirësimin e kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator në nivel lokal, për një menaxhim më efektiv dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Hartimin e një programi të qartë për investime dhe sigurimin e burimeve financiare, si nga buxheti vendor, ashtu edhe nga fondet qeveritare dhe burime të tjera ndërkombëtare;
- Ngritjen e kapaciteteve teknike dhe administrative në Bashkinë Patos për implementimin dhe ndjekjen e Planit.

Në këtë proces, edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit përbëjnë një element kyç për suksesin e planit. Ndërgjegjësimi qytetar mbi rëndësinë e ndarjes së mbetjeve në burim, reduktimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin do të jetë thelbësor për ndërtimin e një kulture të re të menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve në Bashkinë Patos. Plani parashikon zhvillimin e fushatave të edukimit dhe informimit për të gjitha grupmoshat dhe nivelet e shoqërisë, duke përfshirë veçanërisht institucionet arsimore, bizneset dhe organizatat e shoqërisë civile.

Menaxhimi i mbetjeve i është deleguar njësisë të vetëqeverisjes vendore që nga viti 1994, duke i bërë ato përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e këtij shërbimi jetik.

Hartimi i PLMIM është një detyrim ligjor i përcaktuar në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar, ku neni 12, pika 2, përcakton se:

“Çdo njësi e qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me Planin Kombëtar dhe Planin Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”.

Menaxhimi i mbetjeve në bashkinë Patos, ashtu si në shumë bashki të tjera, përballet me sfida të shumta si rritja e vazhdueshme e sasisë së mbetjeve, mungesa e sistemit të ndarjes në burim, pranisë së deponive të pakontrolluara, dhe ndikimi i tyre në mjedis dhe shëndetin publik. Në këtë kontekst, hartimi i një Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve bëhet i domosdoshëm për:

- Organizimin dhe modernizimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve;
- Vendosjen e standardeve për grumbullimin selektiv dhe trajtimin e mbetjeve;
- Përmbytjen e kërkesave ligjore kombëtare dhe angazhimeve ndërkombëtare.
- Zvogëlimin e ndikimit negativ të mbetjeve në mjedis, ujëra, tokë dhe ajër;
- Nxitjen e pjesëmarrjes aktive të komunitetit përmes edukimit dhe ndërgjegjësimin;
- Promovimin e një ekonomie më të gjelbër dhe zhvillimit të qëndrueshëm lokal.

Ky plan i jep Bashkisë Patos një mjet strategjik dhe operativ për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve dhe për të garantuar mbrojtjen e burimeve natyrore për brezat e ardhshëm.

Në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Miratuar Maj 2020) është prezantuar një metodologji mbi bazën e prioriteteve të bashkisë për menaxhimin e mbetjeve, për të përcaktuar se cili do të konsiderohet standardi minimal për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Bashkia Patos gjatë 6 vjeçarit të zbatimit të planit lokal për menaxhimin e mbetjeve kërkon mbi të gjitha të konsolidojë shërbimin në zonat ku aktualisht e ofron këtë shërbim, duke rritur gradualisht cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe ta shtrijë atë në zonat ku aktualisht nuk e ofron shërbimin, kryesisht në zonat rurale:

1. Konsolidimi i shërbimit dhe mbulimi 100% i pjesës urbane të bashkisë gjatë periudhës 2025 – 2030.
2. Ngritja dhe forcimi i sistemit të ndarjes së mbetjeve në burim.
3. Zgjerimi i shërbimit nga 85% në 100% gjatë periudhës 2025– 2030.
4. Rritja e mbulimit të kostos operacionale me 10% çdo vit, gjatë periudhës 2025-2030.
5. Përmirësimi i mbledhjes së tarifës dhe efikasitetit financiar të shërbimit.
6. Reduktimi i ndotjes mjedisore dhe mbrojtja e burimeve natyrore.
7. Zhvillimi i bashkëpunimeve me shkolla, komunitetin dhe bizneset për edukim mjedisor.
8. Përfshirja e inovacionit dhe teknologjisë në menaxhimin e mbetjeve.
9. Të promovojmë një ekonomi qarkore në nivel lokal duke reduktuar mbetjet, rritur riciklimin dhe ripërdorimin e materialeve si dhe duke krijuar mundësi të reja ekonomike përmes valorizimit të mbetjeve dhe përfshirjes së komunitetit dhe bizneseve në praktika të qëndrueshme.

PLMIM rivijëzon objektivin kyc për menaxhimin e mbetjeve në bashkinë Patos si mëposhtë:

“Të zhvillohet një sistem i integruar, i qëndrueshëm dhe eficient për menaxhimin e të gjitha rrymave të mbetjeve në Bashkinë Patos, duke përmirësuar infrastrukturën, rritur ndërgjegjësimin qytetar, ulur sasinë e mbetjeve që shkojnë për asgjësim dhe promovuar qasjen e ekonomisë qarkore.”

Në këtë aspekt, menaxhimi i mbetjeve do të kryhet pa vënë në rrezik shëndetin e njerëzve dhe pa dëmtuar mjedisin në vecanti:

- a) Pa rrezikuar ujin, ajrin, tokën, bimët dhe kafshët.
- b) Pa shkaktuar prishje të qetësisë publike me anë të zhurmave dhe aromave të rënda.
- c) Pa ndikuar negativisht peizazhin jashtë qendrave të banuara.

PLMIM udhëhiqet sipas SKMIM (2018-2033) dhe legjislacionit përkatës për menaxhimin e mbetjeve në nivel kombëtar dhe europian dhe ai luan një rol kyç në arritjen e menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve.

Menaxhimi i mbetjeve do të kryhet në disa stade:

1. Grumbullimi, transporti dhe depozitimi i sigurt i mbetjeve, angazhimi në drejtim të riciklimit.
2. Sisteme gjithëpërfshirëse për riciklim dhe kompostim.
3. Impiante komplekse për trajtimin e mbetjeve.

- **Kuadri rregullator, institucional për MMN në bashkinë Patos.**

Kuadri ligjor

Legjislacioni shqiptar për mjedisin në përgjithësi dhe menaxhimin e mbetjeve në vecanti ka përpaturar nëpërmjet transpozimit të direktivave të BE.

Në Shqipëri legjislacioni përbëhet nga ligjet e krijuara nga Parlamenti, Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM), dhe Udhëzimet dhe Rregulloret e Ministrive. Me rëndësi të vecantë për menaxhimin e mbetjeve janë ligjet e mëposhtme:

Ligji nr.10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, (I ndryshuar)

Ligji nr.91, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, (I ndryshuar)

Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, (I ndryshuar).

Ligji nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, (I ndryshuar).

Ndër VKM-të që lidhen vecanërisht me këtë fushë janë:

VKM nr. 319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”.

VKM nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.

VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfill-et e mbetjeve”

VKM nr. 178, datë 06.03.2012 “Për incinerimin e mbetjeve”

VKM nr. 177, datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”

2.2.2 Politikat dhe Standartet kombëtare

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta bashkiake në Shqipëri bazohet kryesisht në detyrimet që burojnë nga synimet dhe afatet kohore të përcaktuara nga direktivat e Bashkimit Europian, si pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA). Këto udhëzime lidhen gjithashtu me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve. Drafti i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plani i saj i Veprimit (SKMIM – draft) është përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, e cila aktualisht po finalizon dokumentin për miratim me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM). MSA përcakton aspiratën e Shqipërisë për t’u integruar në BE, duke vendosur objektiva afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve. Përmeshja e këtyre objektivave matet përmes raporteve periodike ndaj institucioneve të BE-së. Këto qëllime janë të integruara në dokumente të tjera strategjike, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014–2020 dhe Draft Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (2015–2020).

2.2.3 Kuadri institucional

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipëri është përgjegjësi e ndarë mes nivelit kombëtar, rajonal dhe vendor.

-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) udhëheq kuadrin ligjor dhe politik për të gjitha llojet e mbetjeve, duke mbikëqyrur edhe administrimin e mbetjeve të rrezikshme.

-Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbulon investimet në infrastrukturë dhe zhvillimin e standardeve dhe teknikave më të avancuara për menaxhimin e mbetjeve bashkiake. Gjithashtu, MIE është përgjegjëse për ciklin e plotë të projekteve që lidhen me ndërtimin e venddepozitimeve rajonale nga planifikimi dhe projektimi deri te zbatimi praktik.

3. PËRSHKRIMI I ASPEKTEVE MJEDISORE KRYESORE QË DUHEN TRAJTUAR NË STUDIMIN E VSM.

3.1 Shtrirja gjeografike

Bashkia e re e Patosit është krijuar nga bashkimi në një administrim të vetëm, të ish bashkisë së Patosit dhe 2 komunave, respektivisht Ruzhdie dhe Zharrëz. Bashkia Patos është pjesë e qarkut Fier

dhe përbëhet nga 3 njësi administrative: Patos, Zharrëz dhe Ruzhdië. Bashkia e re administron qytetin e Patosit dhe 18 fshatra. Bashkia Patos (pas ndarjes së re territoriale) ka një sipërfaqe totale prej 82.5 km² dhe kufizohet nga bashkitë Fier, Roskovec dhe Mallakastër.

3.2 Shtrirja kohore

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve do të shtrihet në një periudhë kohore 2025-2030.

3.3 Aspektet mjedisore kryesore që duhet të trajtohen në studimin e VSM

VSM duhet të identifikojë dhe të vlerësojë ndikimet dhe efektet mjedisore kryesore të mundshme të PLMIM, nëse nuk merren masa për zbutjen e tyre. Efektet përfshijnë ndër të tjera efektet pozitive dhe negative, efektet afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, të përhershëm dhe të përkohshëm dhe efektet kumulative. Gjithashtu duhet të merren parasysh efektet e ndërtimit dhe ato operacionale. Efektet mjedisore kryesore të mundshme të zbatimit të PLMIM pritet të përfshijnë ato që listohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6 Efektet mjedisore të PLMIM

Komponenti mjedisor	Efektet e rëndësishme të mundshme, nëse nuk merren masa për zbutjen e tyre.
Popullsia dhe shëndeti i banorëve	-Afërsia e objekteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve me qendrat e banuara. -Përmirësimi i kushteve për qarkullimin e mjeteve dhe i standarteve Teknike të objekteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve kontribuojnë në mbrojtjen më të mirë të mjedisit dhe shëndetit të banorëve. -Efektet e mundshme në turizëm dhe përdorimet e tokës. -Efekte në cilësinë e ajrit. -Efekte në tokë. -Efekte në cilësinë e ujit -Efekte në qarkullimin e mjeteve dhe rrjetet e transportit. -Ekziston mundësia për prishje të qetësisë publike (zhurma, aroma të rënda etj)
Biodiversiteti, flora dhe fauna	Efekte në florën, faunën dhe habitatet (e ndjeshme)
Përdorimi i tokës	-Efektet në cilësinë e tokës për shkak të reduktimit të lëngut kullues nga mbetjet.

	-Efekte në tokë për shkak të reduktimit të përhapjes së mbetjeve.
Asetet materiale	-Ripërdorimi i materialeve me anë të riciklimit të fraksioneve të caktuara të mbetjeve. -Përdorimi i rrjetit të transportit
Uji	-Ndikime në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. -Ndikime në gjendjen ekologjike të trupave ujore. -Efekte në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore për shkak të reduktimit të mbetjeve të përhapura.
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	-Efekte në emetimet në ajër nga transporti i mbetjeve -Emetimet e gazeve serë nga transporti i mbetjeve. -Reduktimi i emetimeve të gazeve serë nëpërmjet depozitimit të mbetjeve në objektet rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe reduktimi i numrit të vendgrumbullimeve të pakontrolluara dhe jo-higjienike.
Peizazhi	Efekte në karakterin e përgjithshëm të peizazhit.
Trashëgimia Kulturore	-Efekte në tiparet e trashëgimisë kulturore në afërsi të objekteve rajonale të propozuara për menaxhimin e mbetjeve.

3.4 Objektivat mjedisore në bashkinë Patos

Kërkesa bazë për kryerjen e një VSM është paraqitja e detajeve të mjaftueshme rreth kuadrit metodologjik të propozuar për vlerësimin e efekteve mjedisore që mundëson krijimin e një pikëpamjeje rreth kësaj çështjeje. Propozohet që vlerësimi të drejtohet nga objektivat, në mënyrë që për secilën fushë të identifikuar të jetë i mundur vlerësimi kundrejt objektivave mjedisor të përcaktara të VSM.

Në tabelën e mëposhtme janë parashtruar objektivat e VSM që janë marrë në konsideratë për të vlerësuar ndikimet mjedisore të mundshme të PLMIM.

Tabela 7 Objektivat mjedisore të VSM

Subjektet e VSM	Objektivat mjedisore	Synime të mundshme të sugjeruara VSM
Popullsia dhe shëndeti i banorëve	Ruajtja dhe përmirësimi i shëndetit të njerëzve	Përmirësimi i cilësisë së jetës. Mbrojtja e shëndetit të njerëzve.
Biodiversiteti, flora dhe fauna	Mbrojtja e biodiversitetit	Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike

	Mbrojtja e florës dhe faunës dhe habitatet e tyre natyrore.	
Përdorimi i tokës	Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të tokës. Parandalimi i dëmtimeve të tokës përfshi mbrojtjen e strukturës së tokës (erozioni) Rehabilitimi dhe kthimi në gjëndjen e mëparshme të tokës së dëmtuar.	Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të tokës.
Asetet materiale	Përdorimi i kujdesshëm dhe racional i natyrës dhe burimeve të saj	Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit. Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore.
Uji	Gjendje e mirë ekologjike e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Gjendje e mirë kimike e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.	Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i gjendjes së tyre ekologjike. Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i gjendjes së tyre kimike,
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	Mbrojtja dhe ruajtja e cilësisë së ajrit. Parandalimi dhe reduktimi i ndotjes që shkakton dëmtimin e shtresës së ozonit dhe ndryshimet klimatike.	Reduktimi dhe stabilizimi i emetimit të gazeve serë. Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit
Trashëgimia kulturore	Ruajtja e trashëgimisë kulturore.	Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore.
Peizazhi	Ruajtja dhe restaurimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit.	Ruajtja e diversitetit të peizazhit.

Synimet do të merren parasysh gjatë përgatitjes së analizës së gjëndjes mjedisore dhe gjatë vlerësimit mjedisor, me qëllim që të arrihen objektivat mjedisore të VSM për PLMIM.

Bazuar në analizën e gjëndjes mjedisore, do të përcaktohen treguesit duke mbajtur parasysh disponueshmërinë e të dhënave dhe mundësinë e lidhjes direkte mes ndryshimeve në mjedis dhe zbatimit të PLMIM.

3.5 Marrja në konsideratë e objektivave mjedisore në procesin e planifikimit- Bashkia Patos

Në kuadër të procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, për Bashkinë Patos janë identifikuar dhe vlerësuar ndikimet mjedisore kryesore që mund të vijnë nga masat e parashikuara për mbrojtjen e mjedisit. Ky vlerësim mundëson që në një fazë të hershme, të identifikohen masat potencialisht të dëmshme për mjedisin dhe të parashikohen masa parandaluese.

Vendimmarrja mbi zbatimin e masave të veçanta do të bëhet në nivel lokal (Bashkia Patos) dhe në koordinim me nivelin rajonal, në varësi të fushës së ndikimit. Rëndësia e ndikimeve mjedisore të pritshme dhe masave përkatëse do të vlerësohet përfundimisht gjatë procedurave të planifikimit dhe miratimit të projekteve.

Sugjerime për procedurat e planifikimit në Bashkinë Patos:

- Uji dhe toka – Duhet të vlerësohet gjendja e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore në territorin e Bashkisë Patos, duke përfshirë balancën ujore dhe cilësinë e tokës, për të shmangur ndotjen nga depozitimi i mbetjeve. Masat për mbrojtjen e ujit dhe tokës duhet të përfshihen që në fazën e planifikimit.
- Cilësia e ajrit dhe klima – Duke qenë se Patosi është zonë me aktivitete të përqendruara të industrisë së naftës dhe gazit, është e rëndësishme që masat për menaxhimin e mbetjeve të marrin parasysh emetimet e mundshme të pluhurit, gazrave dhe aromave, sidomos pranë zonave të banuara.
- Trashëgimia kulturore dhe peizazhi – Në territorin e Patosit gjenden elementë të trashëgimisë arkeologjike dhe peizazhe me vlera historike e natyrore, të cilat duhen mbrojtur nga ndikimet e depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve. Kjo kërkon vlerësim paraprak për çdo projekt që mund të preki këto zona.
- Burimet natyrore dhe materialet – Patosi ka rezerva të rëndësishme naftë dhe gazi. Çdo projekt për menaxhimin e mbetjeve duhet të marrë parasysh ndikimin e mundshëm në zonat e shfrytëzimit të burimeve nëntokësore dhe ndikimin ekonomik në proceset dytësore të prodhimit.

4. Gjendja mjedisore aktuale dhe problematikat kryesore në Bashkinë Patos, përfshirë zhvillimin e mundshëm të mjedisit në mungesë të PLMIM

Karakteristikat kryesore të mjedisit në territorin e Bashkisë Patos lidhen ngushtë me historikun e gjatë të aktiviteteve të nxjerrjes së naftës, përhapjen e mbetjeve të ngurta urbane dhe menaxhimin jo gjithmonë të strukturuar të tyre. Aktualisht, problematikat më serioze mjedisore përfshijnë:

- Depozitime të pakontrolluara të mbetjeve në disa zona rurale dhe periferike.
- Ndotje e tokës dhe ujërave nga aktivitetet historike dhe aktuale të industrisë së naftës.
- Mungesë e infrastrukturës së mjaftueshme për grumbullim dhe trajtim të mbetjeve të ngurta.

Nëse nuk zbatohet PLMIM, zhvillimi i mjedisit në Bashkinë Patos mund të ndjekë një skenar negativ me rritje të ndotjes, humbje të vlerave të peizazhit dhe ndikime serioze mbi shëndetin publik. Kjo do të sillte:

Harta e Bashkisë Patos

4.1.1 Shtrirja gjeografike

Bashkia Patos është pjesë e qarkut të Fierit ndodhet 7 km në jugperëndim të qytetit të Fierit, shtrihet përgjatë vargut kodrinor i cili ndan fushën e Myzeqesë nga lugina e lumit Gjanica. Me një sipërfaqe prej 82.5 km², territori i Patosit të sotëm përfshin nën juridiksionin e saj dy njësitë administrative Zharrëz dhe Ruzhdië. Nga pikëpamja administrative, Patosi kufizohet në perëndim nga territoret e njësisë administrative Portëz, në veri kufizohet me territoret e njësisë administrative Zharrëz dhe në lindje nga territoret e njësisë administrative Ruzhdië.

Tabela më poshtë paraqet parashikimin për numrin e popullsisë së bashkisë Patos për periudhën kohore të masave të propozuar për PLMIM deri në vitin 2030.

Tabela 8. Parashikimi i popullsisë në bashkinë Patos

Bashkia	2023	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Patos	18 227	17 000	16 420	15 840	15 270	14 720	14 200

4.1.2 Parashikimi për prodhimin dhe grumbullimin e mbetjeve

Aktualisht bashkia Patos si sistem monitorimi për sasi të mbetjeve të grumbulluara ka peshimin e mbetjeve në landfillin e mbetjeve Fier. Shifrat e siguruara janë përdorur si bazë për planifikimin e mëtejshëm në kuadër të PLMIM.

Tabela 9. Sasi të mbetjeve që prodhohen dhe grumbullohen në territorin e bashkisë Patos janë përlogaritur si mëposhtë:

Njësia Administrative	Të prodhuara (ton)	Të grumbulluara (ton)	Norma e grumbullimit
Patos	1,800	1,600	90%
Ruzhdië	850	510	60%
Zharrëz	1,198.19	789	65,8%
Total	3848.19	2919	75.8%

Norma mesatare e grumbullimit të mbetjeve në territorin e bashkisë Patos është 75,8 % veçanërisht në zonat rurale kjo normë është e ulët 60 % për shkak të infrastrukturës së kufizuar.

Rekomandohet

- Vendosja e sistemit elektronik për monitorimin e mbetjeve.
- Rritja e frekuencës së grumbullimit në zonat rurale.
- Edukimi i komunitetit për ndarjen e mbetjeve dhe riciklimin.

Tabela 10 Parashikimi i prodhimit të mbetjeve për bashkinë Patos

Viti	Mbetje të prodhuara (ton/vit)
2024	3848
2026	3800
2028	3740
2030	3700

Për parashikimin e prodhimit të mbetjeve është marrë parasysh ulja graduale e numrit të popullsisë dhe përmirësimi i sistemit të riciklimit. Nëse bashkia Patos investon në ndarje në burim dhe kompostim këto shifra mund të ulen edhe më tepër.

Tabela 11 Parashikimi i normave të grumbullimit dhe sasisë së mbetjeve të grumbulluara në bashkinë Patos

Viti	Njësia Administrative	Norma %	Sasia e prodhuar (ton)	Sasia e grumbulluar (ton)
2024	Patos	90	1900	1710
	Ruzhdie	60	880	528
	Zharrëz	65.8	1200	789.6
	Totali	78.2	3848.19	3027.6
2026	Patos	91	1862	1694.4
	Ruzhdie	65	862	560.3
	Zharrëz	68	1176	799.7
	Totali	81	3900	3154.4
2028	Patos	92	1825	1679
	Ruzhdie	70	845	591.5
	Zharrëz	70	1152	806.4
	Totali	84	3822	3077
2030	Patos	93	1790	1664.7
	Ruzhdie	75	828	621
	Zharrëz	73	1128	823.4
	Total	86.5	3746	3109.1

4.1.3 Përbërja e mbetjeve

Bazuar në karakteristikat urbane dhe rurale të territorit, në Bashkinë Patos gjenerohen këto rryma kryesore të mbetjeve:

1. Mbetje urbane të përziera
 - Të prodhuara nga familjarët, institucionet dhe tregtia.
 - Përbëjnë shumicën e mbetjeve të grumbulluara.
2. Mbetje të riciklueshme
 - Plastikë, letër/karton, kanaçe, qelq.
 - Aktualisht nuk grumbullohen të ndara në burim.
3. Mbetje inerte (ndërtimi dhe prishjeje)
 - Të gjeneruara nga ndërtime individuale, rikonstruksione ose ndërtime publike.
 - Shpesh përfundojnë në zona jo të autorizuara.
4. Mbetje bujqësore dhe organike
 - Kryesisht mbetje bimore dhe kafshësh nga zonat rurale.
 - Kanë potencial për kompostim, por nuk trajtohen aktualisht.

4.1.4 Mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet mbetjet inerte

Mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet (MNP) përbëjnë një kategori të veçantë të mbetjeve të ngurta, me ndikim të konsiderueshëm në mjedis dhe në estetikën urbane të Bashkisë Patos. Këto mbetje përfshijnë materiale si beton, tulla, llaç, asfalt, gurë dhe mbetje të tjera inerte që gjenerohen gjatë aktiviteteve të ndërtimit, rikonstruksionit dhe prishjes së objekteve.

Problematika kryesore:

- Hedhja e pakontrolluar në natyrë, përgjatë rrugëve rurale, në përroje dhe në toka të pashfrytëzuara.
- Mungesa e një sistemi të dedikuar për grumbullimin dhe trajtimin e MNP.
- Prania e tyre në kontenierët e mbetjeve bashkiake, duke vështirësuar procesin e grumbullimit dhe rritur kostot e trajtimit.

Vlerësimi i sasive të MNP për Bashkinë Patos (përlllogaritje e përafërt për vitin 2024):

Në Shqipëri, mbetjet inerte zakonisht përbëjnë 10-20% të mbetjeve të ngurta urbane (sipas studimeve të Bankës Botërore).

Nëse 3,848.19 ton janë mbetje totale atëherë $MNP=10-20\%$ e 3,848.19 ton = 384.8-769.6 ton

Rekomandime për menaxhimin e MNP në Patos:

- Krijimi i një zone të dedikuar për depozitimin e mbetjeve inerte me kontroll mjedisor.

- Vendosja e tarifave të diferencuara për subjektet ndërtimore për të stimuluar trajtimin e rregullt.
- Fushata ndërgjegjësimi për ndarjen e MNP nga mbetjet bashkiake.
- Integrimi i MNP në strategjinë e përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve të ngurta.

4.2 Përshkrimi i shërbimit ekzistues të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Patos.

Aktualisht, menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë Patos ofrohet nga Agjencia e Shërbimeve Publike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar. Shërbimi mbulon të gjitha njësitë administrative të territorit të bashkisë, duke përfshirë zonat urbane dhe disa zona rurale të aksesueshme.

Elementët kryesorë të shërbimit

1. Grumbullimi – Mbetjet komunale grumbullohen në pika të caktuara, të pajisura me kontenierë metalikë ose plastikë me kapacitet 1.1 m³, të shpërndarë kryesisht në qendrat e banuara dhe përgjatë rrugëve kryesore. Në disa zona rurale përdoret metoda e grumbullimit “derë më derë”, por në mënyrë të pjesshme.
2. Transporti – Transporti i mbetjeve kryhet me automjete të tipit kamion-kompaktor dhe kamionë të hapur për mbetjet inerte apo voluminore. Frekuenca e transportit ndryshon sipas sezonit dhe dendësisë së popullsisë (më e lartë në zonat urbane).
3. Depozitimi – Aktualisht, mbetjet urbane përfundimtare transportohen në impiantin e trajtimit të mbetjeve Fier. Riciklimi dhe përzgjedhja kryhen në mënyrë sporadike nga individë privatë.
4. Menaxhimi i mbetjeve të veçanta – Nuk ka një sistem të konsoliduar për mbledhjen e mbetjeve të rrezikshme shtëpiake, mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike (EEE), apo mbetjeve të ndërtimit, përveç disa rasteve kur këto menaxhohen përmes kontratave të veçanta.
5. Ndërgjegjësimi publik – Bashkia zhvillon herë pas here fushata sensibilizimi për reduktimin e mbetjeve, ndarjen e tyre në burim dhe mbrojtjen e mjedisit, por pjesëmarrja e komunitetit mbetet e kufizuar.

Vlerësim teknik

Sistemi ekzistues mbështetet kryesisht në modelin tradicional të “grumbullim–transport–depozitim”, me nivel të ulët të ndarjes në burim dhe mungesë të infrastrukturës për trajtim e riciklim të mbetjeve brenda territorit. Përmirësimet prioritare përfshijnë:

- Zgjerimin e mbulimit në zonat rurale të thella
- Vendosjen e sistemit të ndarjes së mbetjeve në burim
- Krijimin e një pike transferimi ose impianti të përpunimit mekaniko-biologjik
- Forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit sipas kërkesave të legjislacionit mjedisor

4.3 Popullsia dhe shëndeti i njerëzve

4.3.1 Gjendja mjedisore dhe problematikat kryesore

Bashkia Patos karakterizohet nga një mjedis natyror dhe rural ku kryesisht dominojnë aktivitetet bujqësore dhe ato të nxjerrjes së naftës. Në territorin e saj gjenden zona me tokë bujqësore, sipërfaqe pyjore të kufizuara dhe një rrjet hidrografik i vogël. Klima është mesdhetare, me verë të nxehtë dhe dimër të butë, duke ndikuar drejtpërdrejt në ciklin e prodhimit bujqësor.

Megjithatë, në këtë territor ka një përqendrim të lartë aktivitetesh hidrokarbure, çka e bën mjedisin e Bashkisë Patos një nga më të ekspozuarit në Shqipëri ndaj ndotjes së ajrit, tokës dhe ujërave.

Problematikat kryesore mjedisore

1. Ndotja e ajrit

- Aktivitetet e shpimit dhe nxjerrjes së naftës gjenerojnë ndotës si komponimet organike të paqëndrueshme (VOC), dioksidi i squfurit (SO_2), oksidet e azotit (NO_x) dhe grimcat e imëta (PM_{10} , $\text{PM}_{2.5}$).
- Mungesa e një sistemi monitorimi të përhershëm në territorin e Patosit e vështirëson vlerësimin e saktë të cilësisë së ajrit.
- Erërat në fushën e Myzeqesë shpesh shpërndajnë ndotësit, por nuk e eliminojnë ndikimin e tyre afatgjatë në shëndet.

2. Ndotja e tokës

- Depozitimi i mbetjeve të naftës dhe derdhjet aksidentale kanë ndotur zona të konsiderueshme toke, duke ndikuar në prodhimin bujqësor dhe biodiversitet.
- Në disa raste, mbetjet inerte dhe urbane hidhen në mënyrë të pakontrolluar në periferi të vendbanimeve.

3. Ndotja e ujërave

- Shkarkimi i ujërave teknologjikë nga aktivitetet naftëmbajtëse përbën rrezik për ndotjen e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.
- Kanalet kulluese bujqësore shpesh janë të bllokuara dhe mbartin mbetje urbane.

4. Menaxhimi i mbetjeve

- Mungon ndarja e mbetjeve në burim dhe riciklimi praktikisht nuk kryhet në shkallë të gjerë.

Tabela 12 Mangësitë mjedisore të sistemit aktual të MMU lidhur me popullatën dhe shëndetin e njerëzve.

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Nivele të ulëta të grumbullimit të mbetjeve	Shpërndarja e mbetjeve dhe hedhja e tyre pa kriter sidomos në zonat ku deri tani nuk ka sistem për grumbullimin e mbetjeve ndikojnë negativisht në situatën higjienike të këtyre zonave Përdorimi ujërave të kontaminuara sipërfaqësore apo nëntokësore si ujë të pijshëm ose ujë për vaditje favorizon futjen e ndotësve në zinxhirin ushqimor të njerëzve dhe/ ose të kafshëve
Nivele të ulëta të riciklimit dhe mungesa e grumbullimit të diferencuar (përfshi fraksionet e mbetjeve organike)	Aktivitetet informale të ndarjes së mbetjeve (si nëpër kontenierët e mbetjeve brenda vendbanimeve edhe në vendgrumbullime/ vend depozitime) vazhdojnë të zhvillohen në kushte pune të këqija që i ekspozojnë punëtorët informalë ndaj risqeve të shëndetit Përdorimi i ujërave të kontaminuara sipërfaqësore ose nëntokësore për ujë të pijshëm ose për vaditje shkakton futjen e ndotësve në zinxhirin ushqimor të njerëzve dhe/ ose kafshëve, duke sjellë rreziqe për shëndetin e banorëve
Depozitimi në vendgrumbullime të pakontrolluara ose të keqmenaxhuara	Mbetjet e shpërndara dhe pirgjet e mbetjeve/ vendgrumbullimet e keqmenaxhuara tërheqin parazitë, të cilët mund të transmetojnë sëmundje tek njerëzit dhe tek kafshët Mbetjet e shpërndara dhe pirgjet e mbetjeve/ vendgrumbullimet e keqmenaxhuara lejojnë futjen e kafshëve shtëpiake që ushqehen me lëndën e mbetjeve (përfshi letrën dhe plastikën), duke shkaktuar futjen e ndotësve në zinxhirin ushqimor të njerëzve Emetimet e pluhurit dhe të aromave të rënda ndikojnë tek receptorët e ndjeshëm në afërsi Aktivitetet informale të ndarjes së mbetjeve në kushte pune shumë të këqija shkaktojnë rrezik për shëndetin e mbledhësve informalë nga komuniteti rom Pjesët e lehta të mbetjeve të hedhura/ depozituara ngrihen nga era dhe ndotin zonat përreth

4.4 Biodiversiteti, flora dhe fauna

4.4.1 Gjëndja mjedisore dhe problematikat kryesore

Bashkia Patos, ndonëse e njohur kryesisht për aktivitetet e nxjerrjes së naftës dhe bujqësinë intensive, ruan ende elementë të rëndësishëm të biodiversitetit që lidhen me ekosistemet bujqësore, zonat pyjore, sipërfaqet ujore dhe kullotat natyrore.

1. Ekosistemet dhe llojet kryesore të habitateve

- Zonat bujqësore – përfshijnë sipërfaqe të mëdha të mbjella me drithëra, ullinj, vreshta dhe kultura të tjera. Këto krijojnë mozaik peizazhi që mbështet një numër të madh organizmash, sidomos insekte pllenues si bletët, fluturat dhe disa shpend të vegjël.
- Habitatet pyjore dhe shkurret – të pranishme kryesisht në zonat kodrinore dhe periferike, ofrojnë strehim për gjitarë të vegjël, reptilë dhe amfibë.
- Ekosistemet ujore – përfshijnë kanalet vaditëse, rezervuarët dhe lumenjtë e vegjël, të cilët janë zona të rëndësishme për amfibët, peshqit vendas dhe shpendtë ujqorë.
- Kullotat dhe livadhet natyrore – mbajnë një larmi të madhe floristikore, veçanërisht bimë mjekësore dhe aromatike.

2. Vlerat e biodiversitetit

- Patosi ka një potencial të lartë për biodiversitet bujqësor, veçanërisht për ruajtjen e varieteteve tradicionale të kulturave dhe racave autoktone të bagëtive.
- Në zonat e gjelbra dhe pyjore gjenden specie me rëndësi ekologjike si dhelpra, lepuri, iriqi, dhe disa lloje hardhucash dhe bretkosash.
- Flora përfshin një gamë të gjerë bimësh të egra, përfshirë disa me përdorim mjekësor.

3. Problematikat që ndikojnë biodiversitetin

- Ndikimi i industrisë së naftës – ndotja e tokës dhe ujit nga derdhjet e naftës dhe mbetjet e industrisë përbën kërcënim për tokën pjellore dhe ekosistemet përreth.
- Shpyllëzimi dhe degradimi i habitateve – pastrim i tokës për zgjerim të sipërfaqeve bujqësore dhe ndërtim.
- Përdorimi i pesticideve dhe plehrave kimike – ndikon negativisht në shëndetin e tokës.
- Mbjetet urbane dhe inerte – hedhja e tyre në mënyrë të pakontrolluar dëmton habitatet natyrore.

Mundësi për përmirësim

- Krijimi i korridoreve ekologjike midis zonave natyrore dhe bujqësore.
- Rehabilitimi i zonave të ndotura nga nafta dhe rikthimi i tyre në përdorim natyror ose bujqësor.
- Promovimi i bujqësisë organike dhe ulja e përdorimit të pesticideve.
- Mbjellja e pemëve dhe krijimi i brezave mbrojtës kundër erozionit.
- Edukimi i komunitetit për rëndësinë e biodiversitetit dhe rolin e tij në mirëqenien e përgjithshme.

Tabela 13 Mangësitë Mjedisore të sistemit aktual MMN në lidhje me biodiversitetin, florën dhe faunën.

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Niveli i ulët i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve	Depozitimi i mbetjeve në mënyrë të padiferencuar jo vetëm që ka ndikim negativ në mjedis, kosto më të lartë menaxhimi por ka dhe ndikim negativ në zhvillimin e turizmit.

4.5 Përdorimi i dheut dhe tokës dhe asetet materiale

4.5.1 Gjëndja mjedisore dhe problematikat kryesore.

Territori i Bashkisë Patos përfshin kryesisht zona bujqësore, tokë të punueshme, sipërfaqe me shkurre, si dhe hapësira të kufizuara pyjore e livadhore. Tokat bujqësore janë ndër asetet kryesore materiale të bashkisë, të cilat përbëjnë bazën për aktivitetin ekonomik lokal. Megjithatë, përdorimi i tokës dhe dheut përballet me disa problematika të rëndësishme:

Gjendja aktuale

- Tokë bujqësore e intensifikuar – Pjesa më e madhe e sipërfaqes tokësore shfrytëzohet për kultivimin e kulturave bujqësore, si grurë, misër, perime dhe ullinj.
- Shfrytëzim i dheut për ndërtime – Në disa zona, sidomos pranë qendrave të banuara, vërehet përdorim i dheut për ndërtime dhe zgjerime infrastrukturore, shpesh pa masa të plota për rikuperim.
- Asete materiale natyrore – Përfshijnë tokën bujqësore, burimet ujore sipërfaqësore e nëntokësore, si dhe lëndë të para minerale të vogla (materiale inerte).

Problematikat kryesore

1. Erozioni dhe degradimi i tokës
 - Përdorimi i paqëndrueshëm i tokës në disa zona, mungesa e mbjelljeve mbrojtëse dhe shfrytëzimi i pjerrësive pa masa kundër-erozion, po çojnë në humbje të shtresës pjellore.
2. Ndotja nga aktivitetet naftëmbajtëse
 - Si zonë me prani të lartë aktivitetesh nxjerrjeje të naftës, disa parcela toke janë të ndotura me hidrokarbure, duke ndikuar negativisht në pjellorinë dhe përdorimin bujqësor të tyre.
3. Fragmentimi i hapësirave natyrore
 - Zgjerimi i zonave të ndërtuara dhe infrastrukturës ka çuar në reduktimin e lidhshmërisë midis habitateve natyrore, duke ndikuar në biodiversitet.
4. Përdorimi i pakontrolluar i inerteve
 - Nxjerrja e materialeve inerte nga shtrati i lumenjve apo zonave kodrinore pa leje të rregullta dhe pa rehabilitim pas nxjerrjes ka ndikim negativ në stabilitetin e tokës.
5. Mungesa e planifikimit afatgjatë për përdorimin e tokës

- Nuk ekziston gjithmonë një koordinim mes planeve zhvillimore dhe mbrojtjes së tokës, çka rrit rrezikun e degradimit dhe humbjes së aseteve materiale natyrore.

Rekomandime

- Hartimi i një plan-menaxhimi të tokës që parashikon përdorim të qëndrueshëm për bujqësi, pylltari dhe zhvillim urban.
- Monitorimi dhe rehabilitimi i zonave të ndotura nga aktivitetet e nxjerrjes së naftës.
- Vendosja e masave anti-erozion dhe rritja e sipërfaqeve me gjelbërim.
- Regjistrimi dhe mbrojtja e aseteve natyrore e materiale si pjesë e kapitalit mjedisor të bashkisë.

Për përdorimin e dheut dhe tokës, menaxhimi i mbetjeve sot paraqet këto mangësi mjedisore

Tabela 14 Mangësitë mjedisore të sistemit aktual të MMN sa i përket përdorimit të dheut dhe tokës

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Niveli i ulët i riciklimit dhe mungesa e grumbullimit të diferencuar.	Normat e ulëta të riciklimit çojnë në një shfrytëzim të përgjithshëm të burimeve natyrore.

4.6 Uji

4.6.1 Gjendja mjedisore dhe problematikat kryesore

Bashkia Patos përshkohet nga disa rrjedha ujore të vogla, kanale vaditëse dhe kolektorë kullues, të cilët kanë rol të rëndësishëm për bujqësinë dhe ekosistemin lokal. Burimi kryesor i ujit të pijshëm sigurohet nga ujësjellësi rajonal, ndërsa uji për vaditje merret kryesisht nga kanalet dhe rezervuarët lokalë.

Gjendja aktuale e ujërave në territorin e bashkisë është e ndikuar nga presioni i aktivitetit bujqësor, industrisë së nxjerrjes së naftës dhe menaxhimi jo gjithmonë i kontrolluar i ujërave të ndotura. Në disa zona rurale, përdorimi i puseve private për furnizim me ujë nuk shoqërohet gjithmonë me kontrolle periodike të cilësisë, duke rritur rrezikun e kontaminimit.

Problematikat kryesore

1. Ndotja nga aktivitetet bujqësore
 - Përdorimi i lëndëve kimike (pesticide, plehra azotike e fosfatike) mund të shkaktojë ndotje difuze të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

- Shpëlarja e tokave gjatë shirave të fortë çon mbetje të kimikateve drejt kanaleve dhe lumenjve të vegjël.
2. Ndotja nga industria e naftës
 - Shkarkimet aksidentale dhe infiltrimi i hidrokarbureve nga pusët dhe rezervuarët mund të përbëjnë rrezik për cilësinë e ujit nëntokësor.
 - Prania e mbetjeve të shpimeve dhe ujërave teknologjike është një shqetësim i vazhdueshëm.
 3. Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura
 - Nuk ekziston një impiant i centralizuar për trajtimin e ujërave të zeza për të gjithë territorin. Shumica e zonave rurale përdorin gropa septike, të cilat mund të kontribuojnë në ndotjen e ujit nëntokësor nëse nuk mirëmbahen.
 4. Humbjet në rrjetin e ujësjellësit
 - Rrjeti ekzistues në disa zona është i amortizuar, duke shkaktuar humbje të konsiderueshme të ujit të pijshëm dhe rrezik të kontaminimit përmes infiltrimeve.
 5. Degradimi i kanaleve vaditëse dhe kulluese
 - Mungesa e mirëmbajtjes periodike çon në bllokime, mbledhje mbetjesh dhe reduktim të kapacitetit hidraulik.

Tabela 15 Mangësitë mjedisore të sistemit aktual të MMN sa i përket ujit

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Mungesa e ndërgjegjësimit të banorëve për mënyrën e grumbullimit të mbetjeve.	Hedhja pa kriter e mbetjeve inerte çon në bllokimin e rrjedhjeve të ujërave sipërfaqësorë.

4.7 Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë

4.7.1 Gjendja mjedisore dhe problematikat kryesore

Bashkia Patos ndodhet në një zonë me aktivitet të lartë hidrokarburesh dhe zhvillim bujqësor intensiv. Cilësia e ajrit ndikohet nga një kombinim faktorësh natyrorë dhe antropogjenë. Burimet kryesore të ndotjes së ajrit lidhen me:

- Emisionet nga industria e naftës (nxjerrje, përpunim dhe transport), ku shpesh lëshohen komponime organike të paqëndrueshme (VOC), hidrokarbure, dhe gaze të tjera ndotëse si metani dhe dioksidi i squfurit.
- Emisionet nga transporti rrugor, veçanërisht automjete me standarde të ulëta dhe përdorimi i karburanteve me cilësi të dobët.
- Proceset bujqësore, përfshirë djegien e mbetjeve bimore dhe përdorimin e pesticideve që lëshojnë grimca PM₁₀ dhe PM_{2.5}.

Të dhënat e monitorimit direkt mungojnë në territorin e Patosit, por nga ana e bashkisë janë realizuar matje të cilësisë së ajrit dhe kanë rezultuar brenda normave të lejuara por monitorimi i cilësisë së ajrit kërkon një periudhë më të gjatë në kohë.

Faktorët klimatikë

Klima e Patosit është mesdhetare-kontinentale, me verëra të thata dhe të nxehta dhe dimra të butë e me reshje mesatare. Temperatura mesatare vjetore varion nga 15–17°C, ndërsa reshjet variojnë nga 800–1,200 mm/vit. Në vitet e fundit, janë vërejtur:

- Rritje e temperaturave mesatare dhe shtim i periudhave të nxehtësisë ekstreme gjatë verës.
- Reduktim i reshjeve në disa sezona, duke ndikuar në thatësi dhe në rrezikun për zjarre në sipërfaqe pyjore dhe kullota.
- Shpërndarje jo e rregullt e reshjeve, me rritje të rrebesheve të forta që shkaktojnë erozion të tokës dhe dëme infrastrukturore.

Problematikat kryesore

1. Mungesa e stacioneve lokale të monitorimit të ajrit, çka e bën të vështirë vlerësimin e saktë të ndotjes.
2. Ndikimi i aktivitetit naftëmbajtës në rritjen e ndotjes me VOC dhe pluhura industriale.
3. Emisionet nga transporti dhe djegia e hapur e mbetjeve bujqësore.
4. Ndryshimet klimatike që pritet të përkeqësojnë periudhat e thatësisë dhe të nxehtësisë ekstreme, duke ndikuar në cilësinë e ajrit dhe shëndetin publik.
5. Rreziku i smogut në periudha me invers temperature dhe ajër të qetë.

Bazuar në MMN, mund të vihen re këto mangësi mjedisore.

Tabela 16 Mangësitë mjedisore të sistemit aktual të MMN sa i përket cilësisë së ajrit dhe faktorëve klimatikë

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Nivel i ulët i grumbullimit të mbetjeve.	Hedhja pa kriter dhe djegia e mbetjeve veçanërisht në zonat rurale (emetimi i pluhurit, aromave)
Norma të ulëta të riciklimit dhe mungesa e grumbullimit të diferencuar.	Ndikime negative në klimë (potencial për të shmangur emetimet e gazeve serë nëpërmjet riciklimit, emetimet e gazit metan nga mbetjet organike).

4.8 Peizazhi

4.8.1 Gjëndja mjedisore dhe problematikat

Bashkia Patos karakterizohet nga një peizazh i kombinuar mes zonave urbane, bujqësore dhe elementeve natyrore. Territori përfshin fusha të gjera të shfrytëzuara për bujqësi, kodra me vegjetacion të shpërndarë dhe zona me veprimtari industriale, kryesisht të lidhura me nxjerrjen dhe përpunimin e naftës. Në pjesën lindore dhe veriore, peizazhi dominohet nga terrene kodrinore me përdorim të alternuar të tokës, ndërsa zona urbane dhe fshatrat janë të vendosur përgjatë rrugëve kryesore dhe hapësirave të sheshta.

Prania e elementeve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si plantacionet tradicionale të ullirit, hapësirat e gjelbra urbane dhe vendbanimet tipike rurale, përbën një aset të rëndësishëm vizual dhe kulturor për bashkinë.

Problematikat kryesore të peizazhit

- Degradimi vizual nga aktivitetet industriale
 - Aktivitetet e nxjerrjes së naftës dhe infrastrukturat shoqëruese (pusat, tubacionet, depozitat) krijojnë ndikime të dukshme negative në pamjen e peizazhit, sidomos në zonat e afërta me vendbanimet.
- Fragmentimi i hapësirave natyrore dhe bujqësore
 - Zgjerimi i ndërtimeve pa planifikim afatgjatë dhe rrjetet e infrastrukturës rrugore kanë çuar në humbje të vazhdimësisë së peizazhit rural dhe reduktim të hapësirave të hapura.
- Mungesa e mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbra urbane
 - Në disa zona urbane dhe qendra fshatrash, hapësirat e gjelbra janë të pakta ose të neglizhuara, duke ulur cilësinë estetike dhe funksionale të mjedisit.
- Erozioni dhe ndryshimet topografike
 - Shfrytëzimi intensiv i tokës, prerja e vegjetacionit dhe ndërtimet në zona kodrinore kanë shkaktuar erozion të tokës dhe ndryshime në konfigurimin natyror të terrenit.
- Humbja e elementeve tradicionale të peizazhit rural
 - Struktura tradicionale e parcelave bujqësore, gardhet natyrore, kanalet ujitëse dhe plantacionet e vjetra të ullirit janë zëvendësuar ose degraduar nga përdorime intensive dhe ndërtim i pakontrolluar.

Tabela 17 Mangësitë mjedisore të sistemit aktual MMN sa i përket peizazhit

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Niveli i ulët i grumbullimit të mbetjeve.	Përhapja e mbetjeve dhe hedhja e tyre pa kriter sidomos në zonat rurale. Përhapja e mbetjeve dhe hedhja e tyre pa kriter shkaktojnë ndotje të peizazhit.
Niveli i ulët i riciklimit dhe mungesa e grumbullimit të diferencuar.	Rritja e sasive të mbetjeve që duhen depozituar. Shfrytëzimi i burimeve natyrore.

4.9 Trashëgimia Kulturore

4.9.1 Gjëndja mjedisore dhe problematikat kryesore

Bashkia Patos, ndonëse e njohur kryesisht për industrinë e saj naftëmbajtëse dhe aktivitetet bujqësore, zotëron gjithashtu një trashëgimi kulturore të çmuar, që përfshin monumente historike, objekte kulti, arkitekturë tradicionale rurale dhe elemente të trashëgimisë shpirtërore të lidhura me

zakonet dhe traditat vendore. Në territorin e saj gjenden edhe zona me potencial arkeologjik, si dhe vende të lidhura me historinë e zhvillimit të industrisë së naftës në Shqipëri, të cilat përbëjnë pjesë të identitetit historik të komunitetit.

Problematikat kryesore

- Degradimi fizik i objekteve – mungesa e mirëmbajtjes së rregullt dhe ndikimi i kushteve atmosferike çojnë në dëmtimin gradual të monumenteve dhe ndërtesave historike.
- Presioni nga aktivitetet industriale dhe ndërtimet – zgjerimi i zonave të shfrytëzimit të naftës, ndërhyrjet infrastrukturore dhe ndërtimet e reja mund të ndikojnë negativisht në ruajtjen e objekteve të trashëgimisë.
- Mungesa e dokumentimit të plotë – inventarizimi i aseteve të trashëgimisë kulturore nuk është gjithmonë i përditësuar, duke e bërë të vështirë planifikimin për ruajtjen e tyre.
- Ndikimi i faktorëve mjedisorë – erozioni, lagështia dhe ndryshimet klimatike rrisin rrezikun e dëmtimeve strukturore.
- Mungesa e ndërgjegjësimit dhe promovimit – niveli i ulët i promovimit të trashëgimisë kulturore tek komuniteti dhe vizitorët kufizon rolin e saj si burim zhvillimi turistik dhe ekonomik.

Rekomandime

- Inventarizimi dhe dokumentimi i plotë i të gjitha aseteve të trashëgimisë kulturore në territor.
- Hartimi i planeve të mirëmbajtjes dhe restaurimit, duke përfshirë burime financiare nga fondet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Integrimi i trashëgimisë kulturore në strategjitë e zhvillimit turistik dhe ekonomik të Bashkisë Patos.
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për rëndësinë e ruajtjes së këtyre vlerave.

Tabela 18 Mangësitë mjedisore të sistemit të tanishëm MMN sa i përket trashëgimisë kulturore.

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Niveli i ulët i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve.	Përhapja e mbetjeve dhe hedhja e tyre pa kriter sidomos në zonat rurale mund të ndikojë negativisht në zonat përreth.

5.Vlerësimi i ndikimeve mjedisore

5.1 Vlerësimi i alternativave

Ky PLMIM krijon një koncept për komponentët e ardhshëm të MMN. Koncepti i detajuar dhe plani i zbatimit për aktivitete vendore janë pjesë e PLMIM. Bazuar në Master Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake janë identifikuar këto aktivitete të menaxhimit të mbetjeve:

-Transferimi dhe transporti drejt incineratorit Fier.

-Trajtimi kompleks i mbetjeve (incinerimi)

-Venddepozitimi sanitar.

5.2 Qasja metodike për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

PLMIM do të paraqesë masat për një menaxhim më të avancuar të mbetjeve që do të ndërmerren nga bashkia Patos. Përgjithësisht efektet mjedisore lokale përcaktohen bazuar në të dhëna, informacione të detajuara. Ky studim VSM identifikon, përshkruan dhe velerëson ndikimet e mundshme në mjedis të aktivitetëve, masave që propozohen për PLMIM dhe sipas nevojës paraqet dhe masat për të parandaluar dhe zbutur ndikimet mjedisore negative.

Elementët që duhen mbrojtur listohen mëposhtë:

1. Popullsia dhe shëndeti i banorëve.
2. Biodiversiteti, flora dhe fauna.
3. Përdorimi i dheut, tokës dhe asetet materiale
4. Uji
5. Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë
6. Trashëgimia kulturore
7. Peizazhi

Konteksti i mëposhtëm duhet të marrë parasysh për vlerësimin e ndikimeve mjedisore;

Ndikimet mjedisore mund të vlerësohen vetëm deri në masën që specifikohet në PLMIM. Për vlerësimin mjedisor supozohet që masat planifikohen dhe zbatohen bazuar në teknologjinë më të mirë që është në dispozicion. Përshkrimi i secilës masë në PLMIM shërben si bazë për vlerësimin. Ndikimet e mundshme mjedisore vlerësohen gjithmonë në mënyrë kualitative.

Tabela 19 Klasifikimi i ndikimeve mjedisore

B	Klasifikimi
++	Në përgjithësi ndikime mjedisore shumë pozitive
+	Në përgjithësi ndikime mjedisore pozitive
0	Pa ndikim mjedisor domethënës
-	Ndikime mjedisore të mundshme negative
--	Ndikime mjedisore të mundshme shumë negative

5.3 Profilet e VSM të masave të propozuara

Në paragrafët hyrës të secilit profil të VSM, janë përmbledhur masa përkatëse dhe ndikimet e saj mjedisore si dhe rekomandimet për parandalimin dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore negative.

5.3.1 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Mbetjet në bashkinë Patos grumbullohen nga kontenierët dhe transportohen drejt pikës fundore të depozitimit të mbetjeve incineratori Fier. Mungesa e një stacioni transferi bën që mbetjet të transportohen të padiferencuara. Ngarkimi i drejtpërdrejtë i mbetjeve nëpër kontenierët e transportit zgjidh rrezikun e ndotjes së uji apo tokës. Gjatë transportit të mbetjeve mund të ketë ndikime negative si aromat e rënda, pluhuri nga mjetet, zhurma dhe trafiku i mjeteve në rrugën drejt impiantit të trajtimit të mbetjeve.

Largimi i menjëhershëm i mbetjeve, hedhja e mbetjeve vetëm brenda kontenierit mund të përmenden si praktika të mira.

Tabela 20 Vlerësimi mjedisor për transferimin dhe transportin e mbetjeve

Objektivi mjedisor/synimi i VSM	Vlerësimi/ Transferimi i mbetjeve
Popullsia dhe shëndeti i banorëve	
Mbrojtja e shëndetit të banorëve	++
Biodiversiteti, flora dhe fauna	
Mbrojtja e burimeve natyrore	0
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe aseteve materiale	
Reduktimi i përdorimit të burimeve	+
Uji	
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre ekologjik	0
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	
Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazeve serë	+
Trashëgimia Kulturore	
Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore	0
Peizazhi	
Ruajtja e diversitetit të peizazhit	-
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor	
Transporti drejt impiantit	+

5.3.2 Trajtimi mekanik

Objektivat kryesore të aktivitetit të riciklimit janë të kursejnë burimet dhe të minimizojnë ndikimin mjedisor të mbetjeve duke pakësuar sasinë e depozitimit.

5.3.2.1 Përshkrimi i teknologjisë

Diferencimi i mbetjeve bëhet në dy rryma në të riciklueshmet dhe mbetjet e pariciklueshme. Mbetjet e riciklueshme do të merren nga kompanitë e riciklimit dhe të pariciklueshmet do të dërgohen drejt incineratorit. Për realizimin e ndarjes do të ishte i nevojshëm një stacion magazinimi.

5.3.2.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Gjatë procesit të trajtimit, emetimet kryesore janë ato të aromave të rënda, pluhurit dhe zhurmës. Vëmendje e vecantë duhet t'i jepet stafit që do të punojë për ndarjen e mbetjeve. Ajrimi i stacionit të magazinimit ku mund të bëhet ndarja e mbetjeve duhet të jetë i teknologjisë së fundit që të minimizohet ndikimi negativ tek shëndeti i punëtorëve.

Tabela 21 Vlerësimi mjedisor për trajtimin mekanik

Objekti mjedisor/synimi i VSM	Vlerësimi/ Transferimi i mbetjeve
Popullsia dhe shëndeti i banorëve	
Mbrojtja e shëndetit të banorëve	+
Biodiversiteti, flora dhe fauna	
Mbrojtja e burimeve natyrore	0
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe aseteve materiale	
Reduktimi i përdorimit të burimeve	+
Uji	
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre ekologjik	+
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	
Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazeve serë	+
Trashëgimia Kulturore	
Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore	0
Peizazhi	
Ruajtja e diversitetit të peizazhit	0
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor	
Transporti drejt impiantit	+

6. PLANI I MONITORIMIT

Zbatimi i Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve dhe veçanërisht Planit të Veprimit do të bëhet nga Agjencia e Shërbimeve Publike dhe do të monitorohet nga Sektori i Mjedisit dhe Turizmit. Monitorimi do të orientohet drejt objektivave të vendosura në këtë plan dhe do të koordinohet

me aktorët përgjegjës dhe mbështetës të listuara si dhe do të bëhet shqyrtimi i rezultateve të çdo aktiviteti për arritjen e objektivave nëpërmjet masave të planifikuara.

ASHP do të dokumentojë të dhënat teknike dhe financiare për çdo aktivitet dhe masë të marr në zbatim të këtij plani. Këto të dhëna do të përdoren për të vlerësuar performancën e sistemit aktual siç janë efikasiteti dhe rikuperimi i kostove. Rezultatet e vlerësimit do të jenë baza për planifikimin buxhetor afatshkurtër dhe afatmesëm si dhe për rishikimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve.

Figura më poshtë paraqet ecurinë e dokumentimit, raportimit dhe monitorimit në lidhje me zbatimin e Planit.

Figura 3

